



| | | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Pranuar / Dorëzuar Prijmenjao / Predato Received / Delivered | 28 - 09 | 2022 | 2 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKIMSACK | 5738 / 2022 | | 115 | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.680/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.680/2022 të datës 02.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë: kundër organit të Vendimit me Nr. 10-521/10 të datës 15.07.2022 të nxjerrë nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Drejtësisë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.680/2022 e datës 02.08.2022 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 10-521/10 i datës 15.07.2022 i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë.

A r s y e t i m

Ministria e Drejtësisë, më datë 06.06.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me numër Reference:RN00009103 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën “Avokat Shtetëror”, me afatin për aplikim nga data 21.06.2022 deri me datë 28.06.2022, ndërsa sipas shkresave të lëndës është vërtetuar se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit i është refuzuar aplikacionin në fazën e verifikimit paraprak përmes Vendimit me Nr. 10-521/6 të datës 04.07.2022.

Ankuesi më datë 08.07.2022, kundër Vendimit me Nr. 10-521/6 të datës 04.07.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore, me numër protokolli 10-521/8, ndërsa Njësia e Burimeve

Njerëzore me datë 15.07.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 10-521/10 me të cilin i ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi kundër Vendimit me Nr.10-521/10 të datës 15.07.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, më datë 01.08.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është protokolluar me datë 02.08.2022 dhe numër 4460/2022, me pretendimet ankimore se vendimi është nxjerr me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore, procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak se nuk janë respektuar dispozitat e Ligjit Nr.06/l-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për procedurën e plotësimit të pozitës së lirë në kategorinë profesionale-lëvizje brenda kategorisë me kërkesën që të shfuqizohet Vendimi me Nr.10-521/10 të datës 15.07.2022 dhe të anulohet konkursi për lëvizje brenda kategorisë me numër të Referencës RN00009103 i datës 06.06.2022 për pozitën Avokat shtetëror si i kundërligjshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.08.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Drejtësisë. Më datë 19.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ndërsa pas kërkesës së Këshillit, ankuesi përmes e-mailit të datës 27.09.2022 ka dërguar prova shtesë me qëllim të plotësimit të ankesës.

Kryetari i Këshillit për shkak të specifikave të lëndës dhe nevojës për shqyrtime shtesë, me datë 12.09.2022 përmes vendimit me numër: VK.nr.94-1/2022 ankesës A.nr.680/2022 i ka shtyrë afatin e vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë, ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër 4460/2022 me datë 02.08.2022, e parashtruar përmes E-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, të datës 01.08.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Diplome nr.1601 Universitare e datës 03.07.2012 e ankuesit, me shkresat e bashkëngjitura: Certifikatë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me titullin LL.M. Master në të drejtën penale e datës 26.10.2018 me nr. Ref.03-18/320, Certifikatë e datës 31.01.2017, Vërtetim i datës 22.03.2022, Vendim me numër protokollit 10-521/10 i datës 15.07.2022 i nxjerrë nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, Vendim me nr.protokollit 10-521/6 i datës 04.07.2022 i nxjerrë nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë; Konkursi i datës 06.06.2022; Përgjigje në ankesë e datës 18.08.2022 nga NBNJ në Ministrinë së Drejtësisë; Ankesa nr.protokollit 10-521/8 e datë 08.07.2022; Vendim nr. Protokollit 01-174 i datë 23.02.2018 për transferimin e ankueses në pozitë Udhëheqës i sektorit për Burime Njerëzore; Akt emërimi i datës 22.08.2014; Përshkrimi i detyrave të punës; Aplikacioni i ankuesit i datë 27.06.2022 e nxjerr nga sistemi; Certifikatë e datës 05.06.2007; Certifikatë për evidencën penale e datës 327.06.2022 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Certifikatë e datës 27.06.2022 mbi shtetësië; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020, i datës 20.01.2021; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021, i datës 28.01.2022; Certifikatë e datës 223-24.09.2014; Certifikatë e datës 12.09.2014;

Stampa e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, datë 12.09.2022.

Certifikatë e datës 28.05.2012; Certifikatë mars 2015 prej 1/5 faqe; Certifikatë e datës 07-08 tetor 2014; Certifikatë e datës 25.09.2014; Certifikatë e datës 06.11.2014; Certifikatë e datës 09-10 tetor 2014; Certifikatë mars 2015; Certifikatë e datës 28.05.2021; Certifikatë e datës 12-13 shkurt 2015; Certifikatë nëntor 2015; Certifikatë shkurt 2015; Certifikatë e datës 28 shkurt deri me 01 mars 2017; Certifikatë prej 15-16-17 shtator 2015; Certifikatë e datës 07-08 tetor 2014; Certifikatë prej datës 23-24 shtator 2014; Certifikatë prej datës 16-17 mars 2016; Certifikatë e datës 01.05.2021; Certifikatë e datës 09-10 tetor 2014; Certifikatë e datës 12-13 shkurt 2015; Certifikatë prej datës 28 shkurt deri me 01 mars 2017; Certifikatë prej datës 15-16-17 shkurt 2015; Certifikatë prej datës 23-24 shtator 2014; Certifikatë prej datës 16-17 mars 2016.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Akt Emërimit të datës 30.05.2017 me numër prot:505 ka konstatuar se ankuesi ka mbajtur pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit për Punë Normative Juridike", ndërsa përmes Vendimin me numër protokoll 01/174 të datës 23.02.2018 i njëjti është transferuar në pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Burimeve Njerëzore" në Agjencinë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e nenit 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: "Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë", si dhe nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "Konkurrimi për lëvizjen brenda kategorisë është e mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil" ndërsa sipas konkursit të datës 06.06.2022 me numër të Referencës RN00009103 për titullin e pozitës së punës "Avokat Shtetëror", klasa e pozitës "Profesional 1", andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstaton se në këtë procedurë të konkurrimit e cila ka qenë e tipit të mbyllur, kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori, gjegjësisht të konfirmuar në detyrë në kuadër të kategorisë profesionale qoftë brenda institucionit apo institucioni tjetër në kuadër të Shërbimit Civil.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se dispozitat e ligjit material i kanë përcaktuar dhe rregulluar klasat dhe kategoritë e pozitave të punës në kuadër të Shërbimit Civil, respektivisht neni 33 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka përcaktuar se: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendës drejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e Ulët Drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; dhe 2.4. Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë", ndërsa në kuptim të nenit 12 të Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojca Nr.1/7: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Drejtues i Ulët 2 të së njëjtës rregullore, Kolegji i Këshillit

konstaton se pozita të cilën e mban aktualisht ankuesi "Udhëheqës i Sektorit të Burimeve Njerëzore" hynë në **Kategorinë e Ulët Drejtuese** (klasa **Drejtues i Ulët 2**), ndërsa pozita për të cilën është hapur konkursi për lëvizje brenda kategorisë "Avokat Shtetëror", hyn në kuadër të **Kategorinë Profesionale**.

Po ashtu, duke ju referuar Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka specifikuar kushtet dhe kërkesat e veçanta, për lëvizjen brenda kategorisë, përkatësisht me nenin 41 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të kësaj rregullore përcaktohet se: "1. Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civil i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale", Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën "Avokat shtetëror" nuk i ka plotësuar parakushtet ligjore të përcaktuara me dispozitat e kësaj rregullore në rastin konkret, sikurse nuk i ka plotësuar as parakushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ngase i njëjti nuk ka qenë i konfirmuar në detyrë në kuadër të **Kategorisë Profesionale**, dhe se lëvizja brenda kategorisë është e hapur vetëm për lëvizje brenda saj në kuadër të shërbimit civil siç përcaktohet edhe me nenin 40 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, pasi që ankuesi në momentin e aplikimit ka qenë i konfirmuar në detyrë në Kategorinë e Ulët Drejtuese, respektivisht vendimmarrja e njësisë përgjegjëse për ta refuzuar aplikacionin e ankuesit në fazë e verifikimit paraprak është e ligjshme në kuptim të nenit 45 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Vendimi me Nr.10-521/6, i datës 04.07.2022 i Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, lidhur me refuzimin e aplikacionit e ankuesit, si dhe nxjerrjen e Vendimit me Nr.10-521/8, të datës 15.07.2022 të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë, është nxjerr në pajtim me nenin 33, nenin 38 të Ligjit Nr. 06/LI-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 40 dhe nenin 41 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe po ashtu ky vendim përmban elementet e aktit administrativ dhe arsyetimi i tij është në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që kanë vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën juridike ngase pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara në dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.680/2022.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivot të KPMSHCK-së.

